



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE
KOMISIONI I VOTIMIT**

Tiranë, më 11/12/2018

PROCESVERBAL

**I PROCESIT TË VOTIMIT NGA MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E
PROKURORËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE PROKURORË TË
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Sot, më 11/12/2018, ora 19.⁴⁸ në Tiranë, mbahet ky procesverbal për të dokumentuar votimin nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 115, pika 3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve në përputhje me rendin e ditës, votoi për zgjedhjen e 6 anëtarëve prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë sipas raportit të mëposhtëm:
3 prej të zgjedhurve prokurorë pranë gjykatave të shkallës së parë;
2 prej të zgjedhurve prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit;
1 prej të zgjedhurve prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga lista emërore e nënshkruar vërtetohet se morën pjesë 295 prokurorë të të gjithë niveleve.

Votimi nisi në orën 13.10 dhe përfundoi në orën 15.05.

U hapën kutitë e votimit, duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit.

Numri total i votave të hedhura është 1770. Nga numri total i votave, 1544 vota janë të vlefshme dhe 226 janë të pavlefshme.

Sipas kategorive të kandidatëve, numri i votave të hedhura është:

885 vota për kandidatët nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, nga të cilat 778 janë vota të vlefshme dhe 107 janë vota të pavlefshme;

590 vota për kandidatët nga prokuroritë pranë gjykatave të apelit, nga të cilat 478 janë vota të vlefshme dhe 112 janë vota të pavlefshme;

295 vota për kandidatët nga Prokuroria e Përgjithshme, nga të cilat 288 janë vota të vlefshme dhe 7 janë vota të pavlefshme.

Nga numërimi i votave, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët sipas çdo shkalle, si vijon:

Kandidatët nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë:

Znj. Antoneta Sevdari	161 vota;
Z. Besnik Cani	148 vota;
Z. Besnik Muçi	75 vota.
Z. Dritan Prençi	127 vota;
Z. Gentian Osmani	181 vota;
Z. Vatë Staka	86 vota;

Kandidatët nga prokurorët pranë gjykatave të apelit:

Z. Arben Dollapaj	232 vota;
Z. Bujar Sheshi	246 vota.


Kandidatët nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme:

Znj. Anila Leka	86 vota;
Z. Kostaq Beluri	202 vota.

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” kandidatët me numrin më të madh të votave që janë fitues sipas shkallëve të prokurorive janë:

Të zgjedhurit nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë:

Z. Gentian Osmani;



Znj. Antoneta Sevdari;

Z. Besnik Cani.

Të zgjedhurit nga prokurorët pranë gjykatave të apelit:

Z. Bujar Sheshi;

Z. Arben Dollapaj.

I zgjedhur nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme:

Z. Kostaq Beluri.


Procesverbali mbyllet në orën 20.⁰⁴.

KOMISIONI I VOTIMIT

ADNAND KOSOVA



ARQILEA KOÇA



ALFRED PROGONATI

